

AKTI I THEMELIMIT I SUBJEKTIT

ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING SHPK

Në bazë të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Republikës së Shqipërisë, Kodit Etik të Avokatit, ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, ne themeluesit:

- o Z. Eridjon Alimadhi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17.05.1986, lindur në Kuç, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip karte me Nr. Personal I60517060S, i lëshuar nga MB në datën 01.12.2016.
- o Z. Denis Kaca, shtetas shqiptar, i datëlindjes 09.03.1993, lindur në Peshkopi, madhor dheme zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip pasaporte me Nr. Personal J30309063R, me Nr. Pasaporte BF6639859 i lëshuar nga MB në datën 20.10.2021.

miratojmë statutin e subjektit tregtar ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING SHPK, me përmbajtje si vijon:

NENI 1

FORMIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Ortakët dhe administratorë të shoqërisë ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING SHPK janë:

- Z. Eridjon Alimadhi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17.05.1986, lindur në Kuç, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip karte me Nr. Personal I60517060S, i lëshuar nga MB në datën 01.12.2016.
- Z. Denis Kaca, shtetas shqiptar, i datëlindjes 09.03.1993, lindur në Peshkopi, madhor dheme zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip pasaporte me Nr. Personal J30309063R, me Nr. Pasaporte BF6639859 i lëshuar nga MB në datën 20.10.2021.

NENI 2

EMËRTIMI TREGTAR

Emërtimi tregtar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING.


2024



NENI 3

SELIA E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

(1) Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është në adresën: Njësia administrative Nr.4, Rruga Bardhyl, Pallati Nr.8 Hyrja Nr. 1, Kati i dytë, Apartamenti Nr.3, Tiranë. Email: aklawconsulting@gmail.com

NENI 4

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është e pakufizuar.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, bazuar në ligjin nr.55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", konsiston si më poshtë vijon:

Shërbime avokatie. Studio ligjore ofron konsulencë për subjektet personat fizikë dhe juridike, vendas dhe të huaj, si shoqëritë tregtare, organizatat jofitimpruese, fondacionet, konsulencë në lidhje me çështjet organizative, administrimin e biznesit, menaxhimin, marketingun, konsulencë për taksat, tatimet dhe doganat. Perfaqesim ligjor dhe mbrojtje të një pale (civile, penale, administrative, familjare, tregtare, etj) në një proces gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyqimit në Republikën e Shqipërisë.

NENI 6


SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar merr masat e nevojshme për sigurimin e përgjegjësive profesionale, sipas rregullave të përcaktuara në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Republikës së Shqipërisë.

NENI 7

KONFIDENCIALITETI

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e të gjitha informacioneve, akteve dhe dokumenteve që janë siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.



NENI 8
DISPOZITË E FUNDIT

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, gjejnë zbatim dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë dhe Kodit Etik të Avokatit.
Çdo ndryshim i dispozitave të këtij statuti bëhet në të njëjtën mënyrë siç është miratuar ky Statut.

ORTAKËT

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING

Eridjon Alimadhi

Denis Kaca

